

Hapet thirrja për bursa në programin Erasmus + në College of Social and Media Culture, në Poloni, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2021-2022.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në College of Social and Media Culture në Poloni, në kuadër të programit Erasmus +, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2021-2022.

<http://wsksim.edu.pl/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për mësimdhënie;

Fushat e mësimdhënies:

- Teknologji informacioni;
- Shkenca politike;
- Studime kulturore;
- Gazetari dhe komunikim;

<http://wsksim.edu.pl/bwmim/erasmus-plus/for-incoming/study-offer/>

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit;

Bursat përfshijnë:

- 140 EUR në ditë për stafin;
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distance ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze (niveli B2);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë mobiltete në kuadër të programit Erasmus +, nëse po ku;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie i firmosur vetëm nga aplikanti;

**Plani i mobilitetit është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen gjatë periudhës së mobilitetit.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing-1-1.docx

Afati për aplikim: 15 Tetor 2021

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!